

VILMA BELLO

**LIRIA GJUHËSORE E PETRO MARKOS, BURIM I PASURIMIT
TË SHQIPES**

Nuk ka asnjë dyshim se gjuha letrare (ndryshe, gjuha standarde ose standardi gjuhësor), fushën më të përshtatshme dhe mundësitë më të mëdha të pasurimit i gjen, pikërisht, në krijimtarinë letrare. Dhe kjo për dy arsye që janë, përgjithësisht, të njohura: E para, shkrimtarët janë njohësit më të mirë të thesarit gjuhësor dhe përdoruesit mjeshtërorë të këtij thesari, madje, duke mbajtur parasysh gjithë përdorimet, qoftë në krijimtarinë popullore dhe qoftë në krijimtarinë e shkrimtarëve paraardhës; E dyta, sepse, pikërisht në letërsinë, gjuha gjen realizimin e të gjitha potencialeve e të zhërvjelltësisë deri në shkallën e përdorimit figurativ e të përmbysur të elementeve të veçanta gjuhësore e të lidhjeve nga më të pasurat të mundshme në njësi të ndryshme gjuhësore, sidomos në fushën e fjalëformimit dhe të ndërtimit të marrëdhënieve sintaksore¹.

Megjithatë në letërsi, pra në një vepër letrare, krahas elementeve të standardizuara, autori mund të përdorë, dhe zakonisht përdor, edhe fjalë e njësi frazeologjike të marra nga dialekte të ndryshme të gjuhës, ndonjëherë edhe fjalë e shprehje arkaike a të një periudhe të shkuar të historisë, të cilat kanë kaluar në klasën e barbarizmave, e të tjera, që shkrimtari do t'i përdorë për të karakterizuar personazhe të një konteksti të caktuar historik, politik e kulturor, ose edhe për të shënuar luftën dhe dallimet midis brezave a klasave shoqërore në një të kaluar të afërt a të largët.

Në dritën e gjuhës sonë letrare, standardit, do të thoshim, me siguri, që gjuha e veprës së Petro Markos dallon lehtëzi në shkallën e një gjuhe të zhvilluar dhe nxitje e mendimit për këtë kumtesë ka qenë, padyshim, pasuria leksikore që gjejmë në faqet e veprës së tij. Ky leksik është mjaft i gjerë dhe, padyshim, pasuron ndjeshëm gjuhën.

Sa herë bie fjala për Petro Markon, zakonisht përmenden veprat e tij dhe vlerat e kësaj krijimtarië. Natyrisht nuk mungojnë edhe vlerësimet për gjuhën e përdorur prej tij në këto vepra. Gjithsesi, gjuhësia jonë i mbetet ende borxh letërsisë artistike, jo thjesht për të interpretuar formën e shprehjes, por edhe për të ndihmuar pasurimin e përpunimin e saj të mëtejshëm, nëpërmjet veçantive të gjuhës së autorit.²

Një kritik i huaj thotë: “Të flasësh a të shkruash për një shkrimtar të madh, është vështirë dhe lehtë në të njëjtën kohë; vështirë sepse veprat që kanë hyrë në fondin e çmueshëm të kulturës kombëtare kërkojnë vlerësim të matur, ato janë

¹ I. Bajçnica, *Shqipja standarde dhe problem rreth saj*.

² J. Thomai, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f. 56.

njëkohshëm të ndërlikuara e të thjeshta dhe çdo afrim me to shikohet me kujdes; është lehtë sepse vepra e madhe mbetet e madhe dhe vetë dëshmon për veten, pavarësisht nga vlerësimi që i bëhet në kohë të caktuar.”

Gjuha e veprës së P. Markos nuk ka veçori fonetike, morfologjike, leksikore e sintaksore që ta dallojnë dukshëm nga gjuha letrare, standardi, veç disa shtresimeve që përdoren për qëllime e efekte të caktuara stilistike.

P. Marko është vlerësuar e cilësuar si autor i mirëfilltë bashkëkohor, por sot cilësimi në të cilin do të qëndrojmë, është aftësia e tij për të krijuar figura e mjedise përmes përdorimit korrekt të normës gjuhësore dhe prirjes, nga ana tjetër, për pasurim të standardit përmes ringjalljeve nacionale.

Pasurimi i gjuhës është proces ligjësor, objektiv, në të cilin marrin pjesë, më së shumti, shkrimtarët, të cilët, sipas D. Agollit, “e marrin gjuhën dhe koloritin e saj me qumështin e nënës”. Petro Marko është model i shkëlqyer i një gjuhe të pasur që vjen edhe nga një qëmtim i kulturës gojore, i folklorit të popullit.

Kur themi se leksiku është sistem i organizuar mjetesish gjuhësore, kemi parasysh jo vetëm lidhjet dhe kushtëzimet e ndërsjella të njësive leksikore, por edhe lidhjet e kushtëzimet e shtresave e klasave të ndryshme të fjalëve që e përbëjnë këtë leksik. Shtresat brenda leksikut krijohen për shkaqe të ndryshme, të tipareve të përbashkëta të formës dhe të përmbajtjes, të prejardhjes, të përdorimit a të kufizimeve të ndryshme; burimit, kufijve të përdorimit, trullit ose fushës së përdorimit³. Në prozën e Petro Markos i ndeshim thuajse të gjitha shtresat e leksikut. Liria gjuhësore e Markos është shumë komplekse, e larmishme dhe pasuruese e standardit nëpërmjet, sidomos, prirjes për përdorim të leksikut dialektor.

Gjatë leximit të kujdesshëm të veprës gjejmë lëndë të pasur gjuhësore popullore dialektore që, më së shumti, e takojmë në gjuhën e autorit, p.sh.: *shkalloi, rrodhi, përkalidhe, xhinsin tonë, kamarullë, mësallë, cen, çilimi, kamarja, mollois, pirustia, (i) mëngjër, rridhnin çurg, kujë, musëndër, çepele, tërkuzë, mësallë, gërnjë, çoç, krimbth, shoshën e viteve, cipal, bënin fqelo* etj., por edhe në atë të personazheve, p.sh.: *në daç, paç uratën, kaur i qenit, derëbardhë, marr kaç* etj.

Forma dialektore gjejmë edhe në përdorimin e emrave të farefisnisë. *Mëma/mama - mëma...mëma* ime (Nata e Ustikës f. 198); *tat/baba* – m’u kujtua letra e fundit e *tatës* (po aty, f. 150). Përdorimi jo pak i ndjeshëm i tyre na sjell para syve vendlindjen e shkrimtarit.

Por, që raporti i përdorimit të dialektizmave shkon drejt ligjërimit të autorit, kjo nuk do të thotë aspak se ligjërimi i tij është dialektor. Në të dyja këto lloj ligjërimesh gjejmë dialektizma dhe krahinorizma të njëjtë. Kjo, me vetëdije, i ka shërbyer Petro Markos të afrojë ligjërimin e tij me atë të personazheve. Te një shkrimtar i mirë diktohet kujdesi për të zvogëluar sa më shumë, por pa e zhdukur

³ Po aty, f. 58.

Liria gjuhësore e Petro Markos, burim i pasurimit të shqipes

fare, largësinë midis gjuhës së vet dhe gjuhës së personazheve; në përpjekje për t'ia arritur këtij synimi, futen në punë edhe dialektizmat leksikore⁴.

Gjuha në veprën e Petro Markos është në të njëjtën kohë gjuhë lokale e gjuhë kombëtare. E folmja e Bregut dhe e bregdetit shqiptar i dhurojnë Petro Markos një lëndë të pasur gjuhësore, por, gjithsesi, ai prapë i drejtohet shqipes së gjerë, në të cilën gjen ngjyrat krahinore me tingëllimë të veçantë. Dialektet kanë shërbyer e vlejné kurdoherë si gurra të pasurimit e të larmisë shprehëse të gjuhëve të njësuara.⁵

Shtresa e fjalëve dialektore e krahinore në gjuhën e veprës së P. Markos dallon dy grupime të gjera:

- fjalë dialektore e krahinore që kanë forcë tipizuese për personazhet a mjediset, dhe që përdoren me këtë qëllim nga autori

- fjalë dialektore e krahinore që i kanë kapërcyer kufijtë dhe kanë hyrë në përdorim në gjuhën letrare, d.m.th. fjalë që sjellin nuanca kuptimore, emocionale, stilistike plotësuese dhe kështu e kanë humbur forcën tipizuese në letërsinë artistike.⁶

Krijimi i figurave dhe mjedisëve, përshkrimi dhe tipizimi i personazheve realizohet prej shkrimtarit përmes përdorimit korrekt të normës gjuhësore nga njëra anë, dhe risjelljes apo aktkrijimeve vetjake, të cilat priren drejt standardit dhe ledhatojnë e zbukurojnë gjuhën. Marko ka marrë nga ligjërimi popullor dhe ka përdorur fjalë të parme dhe jo të parme, të panjohura ose pak të njohura. Ato i sjellin pasurim standardit, sepse zgjerojnë vargjet fjalëformuese, prejardhjen fjalëformuese dhe semantikën e saj.

Në tërësinë e fjalëve të parme të huazuara prej ligjëritimit popullor, përmendim: *bretku*, *çorbë*, *bathë*, *sinor*, *çurg*, *qilar*, *sënduk*, *cilimi*, *tërkuzë*, *katoi*, *kolibe*, *kaç* etj. Në grupin e fjalëve jo të parme përmendim disa mjete fjalëformuese me prejardhje dialektore e krahinore, që sot shfrytëzohen nga gjuha letrare, p.sh. prapashtesat: *-ës*, *-it*, *-th*, *-nik*, *-ar*, *-o*, *-is*, *-os* etj. në fjalët *çitës* (krehër me dhëmbë), *rrufit* (pak e zjerë), *krimbth* (bimë e egër), *vërsnik* (të një moshe), *gërnjar* (grindavec), *brambullo* (bën zhurmë të mbytur e të ndërprerë, për zjarrin), *sikteris* (largoj), *veremos* (hidhëroj) etj.

Marko shfrytëzon gjedhet fjalëformuese popullore, duke zgjeruar e rritur vargjet fjalëformuese të tipave kompozita, të njohur në standard: *bukëfike*, *flokëverdhë*, *derëbardhë*, *derëzi*, *derëshuar*, *fatzi*, *gjethetharë*, *hallemadhi*, *kokëshkretë*, *leshverdhë*, *ogurzi*, *tirqbardha* *vulëhumbur* etj.

(E hollë, *flokëverdhë*, *fytyrëvogël*, *me dy sy të mëdhenj bojëdeti*, *e veshur hollë*, *e zbathur dhe me gjoks të madh gati përjashta* ... "Nata e Ustikës", f. 38)

⁴ Po aty, f. 140.

⁵ Gj. Shkurtaj, *Kundrimë gjuhësore*, Tiranë 2006, f. 59.

⁶ Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë 2000, f. 104

Sinonimia (leksikore, semantike e sintaksore) dialektore⁷ te autori është një nga burimet e tjera të pasurimit të leksikut të shqipes. Ato pranëvihen për të bërë më të gjallë përshkrimin apo theksuar ligjërimin, duke harmonizuar më të njohurën me më pak të njohurën a më pak të përdorurën, normativen me dialektoren a krahinoren. Gjen në to fjalë të cilat kanë zënë vend në gjuhën e sotme letrare shqipe, si p.sh.: *brambullinte* (zjarri), *mërdhija*, *shtrojë*, *sinor*, *cipal*, *marifet* etj., por interes më të madh paraqesin ato fjalë dialektore, të cilat e pasurojnë gjuhën e sotme në planin kuptimor a të ngarkesave stilistike. P.sh., në gjuhën standarde është si normë fjala *grindje*. Kjo fjalë në trajtën e saj dialektore, të përdorur prej autorit, del *gërnj/ë* dhe me mjete fonetike të shqipes (prapashtesa –ar) dalim në formën *gërnjar/e* (*mjegull gërnjare*). Këto lloj sinonimesh, midis fjalës dialektore dhe fjalës së gjuhës letrare, jo vetëm që nuk e përjashtojnë njëri-tjetrin, por mund të bashkëjetojnë në gjuhë, duke i sjellë asaj pasurim të mëtejshëm⁸. “Nuk shkuam nga e djathta, po u kthym nga e mëngjra” (Nata e Ustikës, f. 158). Pra vihet re përdorimi i njëkohshëm i dy trajtave, edhe normative, edhe dialektore; kjo dëshmon se standardi nuk e pengon lirinë e shkrimtarit, përkundrazi.

Në planin stilistikor-emocional ajo që i dallon disa fjalë dialektore a krahinore nga sinonimet e tyre në gjuhën letrare, është ngjyrimi i veçantë shprehës-emocional ose stilistik i tyre. Fjalë të tilla, si **shkalloi**, **rrodhi** në krahasim me *u çmend*, **çilimi** në krahasim me *fëmijë*, **i pataksur** në krahasim me *i trembur*, **qyfyre** në krahasim me *shaka*, **i veremosur** në krahasim me *i hidhëruar*, **mërzej** në krahasim me *rri*, **honeps** në krahasim me *duroj*, *pëlqej* etj. Në këto raste fjalës dialektore, krahas kuptimit të saj të mirëfilltë, i shtohet edhe ngjyrimi stilistik, shpesh nuanca sharëse, tallëse apo ndonjë nuancë kuptimi më e përpiktë. Vargjet sinonimike e bëjnë më të gjallë rrëfimin e P. Markos.

(*Sokëllimat, gjëmimet, krismat, thirrjet, makinat që nisën të lëvizin, formuan një farë bubullime – “Ultimatumi”*)

(*Herë duke dremitur, herë duke fjetur, herë duke përpëlitur në ëndrra të çuditshme pa kuptim, pa fill e pa mbarim, herë duke dëgjuar kollën ritmike të Maqos, pashë dritën e agimit të parë, pashë copat e qiellit të Ustikës. – “Nata e Ustikës”*)

(*Hoqa këpucët. Çorapet. Pantallonat. Këmishën. Ku është trupi im! Gjoksi im me muskuj! – “Nata e Ustikës”*)

Rrallë ndeshim edhe ndonjë fjalë dialektore me përhapje të kufizuar ose me burim të huaj (apo arkaizma), që nuk sjellin gjë të re në pasurimin dhe përsosjen e leksikut të gjuhës letrare, si p.sh.: **xhelepe** (taksa), **sadaka** (falas).

⁷ Me sinonimi dialektore kemi parasysh ato fjalë (dhe jo trajta e variante dialektore fjalësh), të cilat ruhen dhe përdoren ende nga folësit e një dialekti, dhe që, duke u përqasur me fjalët e gjuhës letrare që shprehin të njëjtin nocion, krijojnë me to çifte sinonimike.

⁸ A. Hidi, *Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe*, STUDIME MBI LEKSIKUN....III, f. 378.

Prurje leksikore dialektore Marko ka sjellë edhe në fushën e togfjalëshave, p.sh.: *qinas bagëti, shtëpi-kolibe, fliste kuturu, bënin dava, i rridhnin çurg, marr kaç, çirrnin faqet (e librit), shosha e viteve, lë nam, u shqepën së ngrëni, kaur i qenit, pllakë-shkëmb, dallgë-oshëtime, tym-jetë, shtëpitë-burg, banesat-burg, pisku i vapës* etj. dhe të frazeologjive.

Në frazeologjinë e tij mbizotërojnë ato që vlerësojnë emocionalisht nocione, cilësi, veprime, të cilat dallojnë për përmbajtjen e ngjeshur kuptimisht, për vlera të shumta stilistike, emocionuese dhe për shprehësi të lartë. Petro Marko nëpërmjet frazeologjisë do të na japë nuanca të mendimeve dhe të ndjenjave, duke dhënë artistikisht personazhe dhe mjedise të realizuara, p.sh.: *lë kockat*, do e hash *si frëngu pulën*, ecnin *me një komb në fyt*, *na mbante shpirtin*, *kalo i në satër*, *shqep në dru*, *më kall datën*, *e mori ferra uratën*, *ju shpëlaftë mortja*, *shumë lart e vret*, *më merr në qafë*, *iu fut zekthi në vesh*, pa ato *çifutët nuk do bënin pashkë* etj.

Në tërësinë e frazeologjizmave të qëmtuara në veprën e tij gjejmë nga ato që nuk kanë tregues dialektore⁹; ato nuk i janë nënshtruar ndryshimeve fonetike, siç ndodh në dialekt, si p.sh.: *na mbante shpirtin*, *shumë lart e vret*, *më merr në qafë*, *lë kockat*, *lexoj mendjen*, *si frëngu pulën* etj., gjejmë, gjithashtu, njësi me burim dialektor a krahinor që janë bërë pronë e shqipes, si p.sh.: *ecnin me një komb në fyt*, *ju shpëlaftë mortja*, *kalo i në satër*, *shumë lart e vret*, *shqep në dru*, *kyç gojën*, *kall datën*, *m'u bë mendja dhallë*, *i mbeti guri në hava* etj.

Përdorime dialektore ka edhe për klasa të veçanta fjalësh, forma të caktuara të të cilave po kthehen në format standarde. P.sh., përdorimi i ndajfoljes *përposh* parapëlqehet te shkrimtari, formë kjo e cila po hyn në standard.

"Hidhnin gurë përposh" - Ultimatum, f. 187.

"Përposh, në shkëmbinjtë e nxirë, vala e detit mezi nxirrte përshpërimat e saj" - Nata e Ustikës, f. 163.

Ndërsa përdorimet parafjalore janë, pothuaj, si format e njohura të normës, p.sh.: *te (tek)*, *më*, *mbi*, *përjetë*, *përtej*, *me* etj.

Struktura sintaksore në rrëfimin e Markos nuk është e rënduar, është e lehtësuar nga fjali të gjata, duke harmonizuar fjali dykryegjymtyrëshe, njëkryegjymtyrëshe, emërore e foljore, me periudha me nënrenditje. Rrëfimi i tij, kështu, bëhet më ritëm të shpejtë, që të tërheq e të përfshin.

"Nga vinte hekuri! Që përtej detit! Hekur ishte jatagani! Hekur ishte maliheri! Hekur ishte tika, kama! Hekur ishte kosa, drapëri! Hekur ishte pirostia, sqepari, sëpata, kazma, lopata, shata....gjëra të vockla në krahasim me duart e ndera për armë e për vegla pune...thoshin se një bregas kishte sjellë në krahë një vare që nga Korinthis, ku emigruar për copën e bukës e për të punuar në çeljen e atij kanali të madh, për të çarë gurë." - Ultimatum, f. 53.

Përdorimi i formave kallëzues shkon kah përdorimeve normative; gjejmë përdorime të shpeshta të formave të përsëritura të së pakryerës, të së tashmes e të së ardhmes

⁹ Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë 2000, f. 17.

“Mjekra e rrumbullaktë e Gotit ishte e zezë. Dhe sytë e tij ishin të zinj. Dhe flokët e zezë i kishte dhe i mbante aq mirë të krehur, sa kurrë nuk mund t’i dilte qoftë edhe një qime. Ishte një burrë mesatar nga trupi, po i mbushur. Mbase, prandaj i bënte dhe xhaketat, dhe pantallonat pak të ngushta, që t’i dukej shtati i fuqishëm dhe i drejtë. Kishte një zgjuarsë që i shërbente arritjes së dëshirave dhe qëllimeve të tij. Zinte shumë kollaj shokë e miq, po edhe shumë kollaj o i linte, o i harronte.” - Ultimatum, f. 203.

“Thonë se zbritjet nga mali nuk të lodhin. Po ato të tundin edhe palcën kur nxiton dhe hidhesh gur mbi gur, siç bënte tani Totua dhe Shyqua. Kurse ngjitjet janë më të vështira, po tendosin mirë edhe kockat, edhe nervat, edhe muskujt, dhe hapat hidhen më ritmin e të rrahurave të zemrës.” - Ultimatum, f. 150.

Mbizotërojnë përdorimet e kallëzuesve të thjeshtë, të cilët paraqiten edhe me forma të ndërlikuara; më e zakonshmja është ajo që shprehet me përsëritjen e së njëjtës formë foljore për të treguar se veprimi paraqitet si më i përfortuar a më i zgjatur, ngjyrim kuptimor të të cilit e jep, pikërisht, forma e përsëritur foljore. Ngarkesa stilistike e kallëzuesit në këto raste është e ndjeshme.

“Dhe, kur u futën brenda luftëtarët e Zigurit, e gjetën ...e gjetën të vranë në mënyrë të turpshme.” - Ultimatum, f. 238.

“E vërteta është se në kohën e Shyqos mendimet zunë të shtoheshin e të shtoheshin që kur u arrestua dhe që kur u rrah nga oficerët e karabinierisë.” - Ultimatum, f. 150.

“...Dyndeshin furtuna romake dhe banorët, si zogjtë, për të shpëtuar nga ato furtuna të tërbuara, fluturonin e fluturonin e pastaj futeshin në follenë e tyre ..” - Ultimatum, f. 298

“E shikoja ...e shikoja dhe s’vura re ku e hodha këmbën ...” - Nata e Ustikës, f. 230.

“Ja, tani më duket sikur diçka e gjallë më ka mbërthyer gjithë gjymtyrët e trupit ...e m’i shtrëngon...e m’i shtrëngon dhe unë sikur nuk marr dot fromë...” - Nata e Ustikës, f. 40.

Të bie në sy përdorimi i formave foljore antonimike dhe kjo del si përdorim i parapëlqyer.

“Ku të bie e ku të shpie, more Shyqo!” - Ultimatum, f. 151

“Këto thirrje dilnin nga barinjtë që venin e vinin vërdallë rrugëve të qeta ...” - Ultimatum, f. 41

“Të tjerët hynin e dilnin” - Ultimatum, f. 240

Forma foljore antonimike dalin edhe në rastet kur ato janë të formuara më parashtesën *sh-*, për efektin stilistik të zbulimit të gjendjes emocionale të personazhit.

“Përpoqi disa herë qepallat dhe plekste e shplekste me nxitim gishtërinjtë e duarve.” - Qyteti i fundit, f. 49.

Në fushën e sintaksës, prurje e thellim në standard është edhe përdorimi pranë e pranë i dy emrave pa lidhje morfologjike si përcaktorë, midis të cilëve ka vetëm

Liria gjuhësore e Petro Markos, burim i pasurimit të shqipes

një ngjashmëri e krahasim kontekstual të pashprehur morfologjikisht¹⁰. P.sh.: *bllok shkëmbi, pllakë shkëmb, tym-jetë, hije-ferri, jetë-ferri, shtëpitë-burg, banesat-burg* etj.

E gjithë lënda e vjelë prej disa prej veprave të Petro Markos, pas një vëzhgimi gjuhësor të kujdesshëm, edhe pse jo shteruese, është burim pasurimi për leksikun poetik të shqipes. Shqipja në penën e Petro Markos ofron lëndë të përshtatshme për vështrime aspektesh të ndryshme gjuhësore. Vlerat dhe prurjet gjuhësore të tij mund të bëhen objekt trajtimi a studimi të hollësishëm, pasi përmes kësaj që u tha, as janë prekur, as janë hetuar të gjitha çështjet që lidhen me leksikun.

Për Rexhep Qosen¹¹, “shkrimtar i mirë, që e ka të siguruar ardhshmërinë gjuhësore, nuk mund të quhet ai që vetëm sa u përmbahet rregullave të drejtshkrimit, duke i respektuar si besimtarët fjalitë e librave të shenjtë. Shkrimtarët, më parë se gjuhëtarët, janë ata që e zhvillojnë e pasurojnë gjuhën, që e zgjerojnë dhe i thellojnë mundësitë e saj shprehëse. Për më tepër, mund të thuhet, këtë detyrë ata nuk do të mund ta kryenin me sukses, në qoftë se do t’i respektonin kërkesat e gjuhëtarëve që shpesh janë kundërshtim me “lirinë” gjuhësore të krijuesve.” Te Marko bashkudhëton njeriu me shkrimtarin, siç shkrimtari me gjuhëtarin. Dhe përmes këtyre dy prirjeve në të cilat rrugëton ai, liria e tij gjuhësore e lejon të zgjedhë fjalën e duhur e të bukur, si edhe të pasurojë gjuhën letrare, standardin.

BIBLIOGRAFI

- J. Thomai, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992.
Gj. Shkurtaç, *Kundërime gjuhësore*, Tiranë, 2006.
I. Baiçnica, *Shqipja standarde dhe problem rreth saj* (Ligjëratë me mësuesit e shqipes në shtetet skandinave, 11-12 maj 2006 Landskrona, Suedi).
Sh. Islamaj, *Gjuha e Jakov Xoxës*, Prishtinë, 2000.
A. Hidi, *Sinonimet dialektore dhe pasurimi i leksikut të gjuhës letrare shqipe*, STUDIME MBI LEKSIKUN....III.
N. Mërkuri, “*Vlora në rrjedhat e kohës*” (botim i Konferencës Shkencore), Toena, Tiranë, 2001.

¹⁰ N. Mërkuri, *Vlora në rrjedhat e kohës* (botim i Konferencës Shkencore), Toena, Tiranë, 2001.

¹¹ R. Qosja, *Panteoni i rralluar*, Tiranë, 1988, f. 617.

GRAMATIKË, HISTORI GJUHE

